

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 2-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 11.1.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishmit nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 2-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 1-rë publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 4.1.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 1-rë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 4.1.2024.
3. Propozim-vendim për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.
4. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep.
5. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive për Radio Aktivitete RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë.
6. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 1-rë publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 4.1.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 1-rë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 4.1.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për rritjen e Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024. Ai shpjegoi se propozimi është që Plani financiar për vitin 2024 të rritet për 5.000.000,00 denarë në bazë të Kërkesës së Asociacionit të Qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ – LRI Shkup që është dorëzuar në Agjenci. Bëhet fjalë për mjete të akumuluar (grumbulluara) nga vitet e kaluara dhe për destinimin e tyre do të diskutohet në seancën e ardhshme kur Këshilli do të marrë vendim për dhënien e donacionit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e rritjes së Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, nr.05-4735/1 datë 22.12.2023.

Të ardhurat dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, rriten për 5.000.000,00 denarë, përkatësisht arrijnë në 168.546.961,00 denarë.

Rritja siguron mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 5.000.000,00 denarë , të destinuara për:

- Ndarja e ndihmës financiare - Donacion për Asociacionin e qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ - LRI Shkup, sipas Kërkesës së tyre të dorëzuar përmes e-mailit më 27.12.2023 ( nr.y në ark.05-33 /1 të datës 2.1.2024), me të cilën kërkojnë donacion nga Agjencia për t'u ofruar ndihmë dhe mbështetje për realizimin e iniciativave të tyre të ardhshme kërkimore.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

### **Pika 4**

Z. Trajçevski sqaroi se Propozim-aktvendimi për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep dhe pika 5 në vijim janë propozime të bazuara në Kërkesë nga transmetuesit të cilët vetë vendosën të ndërpresin me transmetim të programit në radio. Në pajtim me Ligjin, Këshilli duhet të marrë aktvendime për fshirjen e dy transmetuesve nga regjistri që udhëhiqet nga Agjencia.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta boton në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive për Radio Aktivitete RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë .

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta boton në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 6**

##### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI**